

Termet e Referencës

për zhvillimin e Strategjisë së TI-së, Planit të Implementimit dhe
Arkitekturës së Sistemit të AKK-së

Nr. Identifikues i kontratës: XK-KCA-315946-CS-CQS

Tabela e përmbajtjes

1	Historiku.....	3
2	Objektivat.....	4
3	Fushëveprimi i punës.....	4
4	Kohëzgjatja e detyrës.....	5
5	Produktet	6
6	Kriteret e pranimit	6
7	Kualifikimet minimale të kërkuara.....	6
8	Procesi i përzgjedhjes.....	8
9	Raportimi	8

1 Historiku

Qeveria e Kosovës (QK) ka marrë një Kredi nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) e Grupit të Bankës Botërore në vlerë prej 14.60 milion EUR për të financuar Projektin e Kadastrit të Pronës së Paluajtshme & Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP), që pritet të zbatohet brenda një periudhe pesëvjeçare. Projekti i propozuar synon të ndihmojë Qeverinë e Kosovës që të rrisë transparencën dhe cilësinë e administrimit të tokës dhe të dhënave dhe shërbimeve gjeohapësinore. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK) është agjencia zbatuese për projektin REGIP, brenda së cilës do të krijohet Njësia për Implementimin e Projektit (NjIP). NjIP do të jetë përgjegjëse për zbatimin e përditshëm të projektit dhe për ofrimin e mbikëqyrjes teknike specifike të aktiviteteve të projektit. NjIP është përgjegjëse për të gjitha aspektet e besueshmërisë, siç janë prokurimi, menaxhimi financiar, monitorimi dhe vlerësimi, dhe masat mbrojtëse sipas REGIP.

Komponentët e projektit janë Komponenti A - Politika, Mbështetja Ligjore dhe Institucionale; Komponenti B - Modernizimi i Kadastrit; Komponenti C - TIK dhe Infrastruktura Gjeohapësinore dhe Komponenti D - Menaxhimi i Projektit, Ngritja e Kapaciteteve, Informimi i Publikut dhe Monitorimi dhe Vlerësimi.

Komponenti C (TIK dhe Infrastruktura Gjeohapësinore) ka për objekt mbështetjen e zbatimit të Strategjisë së Teknologjisë të Informacionit të AKK-së dhe strategjisë së Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Hapësinor (IKIH), në Republikën e Kosovës. Këto strategji janë hartuar në kuadër të Projektit të mëhershëm të Kadastrit dhe Regjistrimit të Pronës së Paluajtshme (RECAP). Të dy dokumentet e strategjisë tregojnë vizionin për: (a) thjeshtimin e mëtejshëm të proceseve të punës, (b) rritjen e standardizimit të informacionit dhe qasjen në informacion që do të përmirësonte efikasitetin e stafit dhe zyrave, (c) rritjen e transparencës dhe llogaridhënies; (d) qasjen e barabartë në informacion; (e) ngritjen e përdorimit të informacionit dhe shërbimeve gjeohapësinore për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja; dhe (f) minimizimin e mundësive për praktika korruptive.

Të dy strategjitë do të ofrojnë gjithashtu statistika gjinore dhe të dhëna të ndara për vendimmarrje të bazuar në prova dhe do të mbështesin procesin e monitorimit të qeverisjes së burimeve drejt arritjes së agjendës 2030. Kjo do të ofrojë mundësi të reja për qeverinë, komunat, organizatat joqeveritare, akademinë dhe sektorin privat për të zhvilluar shërbime dhe produkte të reja inovative.

Për strategjinë e TI-së së AKK-së, Komponenti C do të investojë në zhvillimin e mëtutjeshëm të Sistemit Informativ Kadastral dhe Tokësor të Kosovës me Arkitekturë të Orientuar në Shërbim (SIKTK-SOA) për të mbështetur thjeshtimin e proceseve të punës, zbatimin e ndryshimeve ligjore dhe reformën institucionale gjatë periudhës së projektit, zhvillimin e shërbimeve elektronike, interoperabilitetin më të madhë me sistemet dhe regjistrat e tjerë qeveritarë përmes *e-Gateway (Platforma e-Kosova)*, asistencën teknike për sigurimin e cilësisë, kontrollin e cilësisë dhe përmirësimin e sigurisë kibernetike, furnizimin me harduer dhe trajnimin teknik. Komponenti do të mbështesë gjithashtu përditësimin e Strategjisë së Teknologjisë së Informacionit për të mbuluar pesë (5) vitet e ardhshme dhe zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie për menaxhimin e arkivave dhe dokumenteve dhe një plani të veprimit. Komponenti do të zhvillojë një standard për arkivimin digjital, digjitalizimin e të dhënave si dhe zhvillimin e e-shërbimeve nga arkivi qendror digjital.

2 Objektivat

Objektivat e përgjithshme të projektit janë:

- *Zhvillimi i Strategjisë së TI-së dhe planit të implementimit të saj për pesë (5) vite për të siguruar miratimin e Strategjisë Kombëtare/Qeveritare të TI-së dhe dokumenteve të ndërlidhura me politikat. Këto dokumente duhet të jenë në përputhje me dokumentet e agjencisë përkatëse si Plani Strategjik i Biznesit të AKK-së, Politika e TI-së, Plani i Rimëkëmbjes nga Fatkeqësitë, etj.*
- *Projektimi i arkitekturës së sistemit të AKK-së*

3 Fushëveprimi i punës

Kompania konsulente do të zhvillojë:

i. Strategjinë e TI-së për një periudhë pesë (5) vjeçare për agjencinë, duke përfshirë planin e implementimit të saj dhe dokumentet e tjera përkatëse. Detyrat specifike për këtë komponent përfshijnë:

- *Strategjinë e TI-së për periudhën 2023-2028;*
- *Kryerjen e analizës SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet) të situatës aktuale të TI-së;*
- *Rishikimin dhe kuptimin e Planit të Biznesit dhe Planit Strategjik të AKK-së dhe të sigurohet që kjo të pasqyrohet plotësisht në Strategjinë e TI-së*
- *Vlerësimin e boshllëqeve ndërmjet mjediseve ekzistuese dhe atyre të kërkuara të TI-së*
- *Analizën e procesit*
- *Riprojektimin e proceseve*
- *Menaxhimin e portofolit të aplikacioneve të biznesit;*
- *Kryerjen e vlerësimit të përshtatshmërisë së infrastrukturës ekzistuese dhe rekomandimin për përmirësime;*
- *Ndjekjen e standardeve të BE-së për TIK, veçanërisht standardizimin e sistemeve dhe komponentëve të mundësuar nga TIK-u për të garantuar interoperabilitet të fuqishëm dhe të gjithanshëm, siguri, përputhshmëri, transportueshmëri, funksionalitet, menaxhim të cilësisë, standarde të përbashkëta të të informacionit dhe ndarjes së informacionit, etj.*
- *Qeverisja e TI-së;*
- *Politikën e TI-së për mirëmbajtje dhe zëvendësim*
- *Planin e menaxhimit të ndryshimeve të TI-së*
- *Planin e proceseve të TI-së*
- *Prioritetet për investimet në TI*
- *Sigurimin e burimeve të TIK-ut (BNJ, kontraktimi vs. nënkontraktimi, teknologjitë e nevojshme)*
- *Specifikimin e marrëdhënieve, detyrimeve dhe detyrave të AKK-së në lidhje me Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (ASHI) dhe institucionin qeveritar përgjegjës për e-Qeverisje për qartësi më të madhe në harmoni dhe raportim;*
- *Zhvillimin e planit të implementimit të Strategjisë së TI-së (koha dhe buxheti) duke përfshirë pikat kyçe dhe matjen e suksesit dhe rikalibrimin (treguesit);*

- Diskutimin e draft Strategjisë së TI-së me AKK-në dhe komentet e dakorduara duhet të inkorporohen në dokumentet përfundimtare të strategjisë;

ii. *Arkitektura e sistemit të AKK-së:*

Arkitektura e re e sistemit të AKK-së pritet të luajë një rol kyç në projektimin, zbatimin dhe sigurimin e sistemeve dhe nën-sistemeve të TI-së - me fokus të veçantë në arkitekturën e sistemit - integrimin dhe përmirësimin e tyre; përveç kompetencës së plotë në TIK-ut (të gjitha fushat: softueri, hardueri dhe rrjetet). Kjo kërkon teknika specifike të projektimit dhe aftësinë për të përshkruar sistemin në termat e komponentëve dhe rrjedhave logjike. Detyrat/përgjegjësitë e përgjithshme përfshijnë:

- Në bashkëpunim me AKK-në, operon në kuadër të detyrave të caktuara nga menaxhmenti, për të identifikuar zgjidhjet për kërkesat e biznesit përmes aplikacioneve të arsyetuara të TI-së. Këto zgjidhje duhet të paraqiten në formën e arkitekturës së TI-së dhe përfshijnë proceset, shërbimet dhe sistemet;
- Bazuar në kërkesat dhe qëllimet e biznesit të organizatës, përcakton proceset e punës për sa i përket aktiviteteve dhe funksioneve, dhe i zhvillon ato në arkitektura plotësisht funksionale të TI-së, duke zgjedhur dhe aplikuar korniza dhe metodologji përshtatshme;
- Përcakton dhe specifikon se si të menaxhohet i gjithë ciklin jetësor i arkitekturës së TI-së, duke kuptuar ndryshimin e kërkesave të biznesit dhe duke përcaktuar gradualisht një zgjidhje teknike të detajuar;
- Rishikon arkitekturën e TI-së për sa i përket bilancit ndërmjet përfitimeve, kostove dhe rreziqeve, duke përfshirë kërcënimet e sigurisë. Siguron financimin e detajuar dhe justifikimin e kostos dhe vlerësimet e ROI (Kthimi nga Investimi);
- Vlerëson efektivitetin e përgjithshëm të arkitekturës së TI-së, efikasitetin e zgjidhjeve individuale të TI-së (përsa i përket pajisjeve të TIK-ut, kapacitetit të procesimit dhe komunikimit, strukturave të të dhënave, objekteve, logjikës së biznesit, etj.) dhe fizibilitetin teknik të zgjidhjeve të reja të propozuara, duke vlerësuar rreziqet e tyre, kostot dhe përfitimet e mundshme;
- Identifikon problemet e integritetit dhe migrimit të sistemeve të trashëguara dhe ofron përgjigje të përshtatshme për sa i përket modeleve dhe zgjidhjeve praktike të zbatimit;
- Zhvillon arkitekturën e ndërmarrjes dhe sistemeve të AKK-së për të mbështetur përmirësimet/zgjerimet e ardhshme;
- Këshillon organizatën për tendencat dhe risitë në zhvillim në lidhje me arkitekturën e TI-së dhe nënvizon praktikën më të mirë në industrinë e ngjashme/përkatëse.
- Zhvillimi dhe specifikimi i arkitekturës së sistemit të AKK-së bazuar në kornizën TOGAF

4 Kohëzgjatja e detyrës

Supozohet se kohëzgjatja e kësaj detyre, e cila përfshin të gjitha detyrat e specifikuara për të gjitha komponentët, do të përgatitet dhe përfundojë gjatë periudhës kohore pesë (5) mujore.

Kjo periudhë kohore përfshin të gjitha aktivitetet nga mbledhja e informacionit deri në dorëzimin e produkteve përfundimtare.

5 Produktet

Kompanisë do t'i kërkohej të sigurojë minimalisht këto produkte kryesore:

	Aktivitetet dhe produktet kryesore	Afati
1	Raporti fillestar dhe plani i punës që adreson qëllimin dhe çështjet kërkimore të kësaj detyre	java 3
	Raporti mbi analizën e agjendës së AKK-së të zbatuar përmes projekteve të kaluara dhe ekzistuese, zbrazëtitrat kryesore në politika dhe praktikë dhe efektiviteti i strategjive aktuale të përdorura në AKK;	java 6
3	Drafti i Strategjisë së TI-së	java 11
4	Strategjia përfundimtare e TI-së, plani i implementimit dhe dokumentet përkatëse pas inkorporimit të komenteve të AKK-së dhe palëve të interesit	java 15
5	Zhvillimi dhe specifikimi i arkitekturës së ndërmarrjes së AKK-së bazuar në kornizën TOGAF	java 20

Të gjitha raportet, prezantimet e kështu me radhë duhet të dorëzohen në të dyja gjuhët, anglisht dhe shqip.

Arkitektura e sistemit duhet të zhvillohet duke përdorur një nga mjetet e licencuara nga TOGAF si:

- Alfabet AG: planningIT 7.1 dhe më i ri
- Evolution: ABACUS 4.0 ose më i ri
- BiZZdesign: BiZZdesign Enterprise Studio
- BOC Group: ADOIT
- Orbus Software: iServer Business and IT Transformation Suite 2015 ose më i ri
- Planview: Troux
- Software AG: ARIS 9.0 ose më i ri
- Sparx Systems: Enterprise Architect v12

6 Kriteret e pranimit

Një produkt do të pranohet nga AKK nëse:

- Ai plotëson fushëveprimin e punës së përshkruar në këtë dokument (seksioni 4) dhe përmban përmbajtjen e përshkruar në seksionin Produktet të këtij dokumenti (seksioni 5) dhe
- AKK nënshkruan Dokumentin e Pranimit (Formulari i Pranimit i disponueshëm në AKK).

Miratimi zyrtar i këtij dokumenti (Formulari i Shtojcës) përbën pranimin e këtyre kriterëve.

7 Kualifikimet minimale të kërkuara

Kompania konsulente duhet të dëshmojë zbatimin e dy kontratave të suksesshme me kompleksitet të ngjashëm në pesë vitet e fundit nga kjo data e Kërkesës së Shprehjes së Interesit për zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë së IT dhe arkitekturave të sistemit. Firma e zgjedhur konsulente (rishikoni seksionin 8. Procesi i Përzgjedhjes) duhet të ofrojë përshkrimin e projektit dhe detajet kontaktuese për secilën referencë.

Stafi kryesor duhet të ketë përvojë të gjerë në zhvillimin e Strategjisë së IT-së dhe dokumenteve të lidhura me to, arkitekturave të ndërmarrjes dhe standardeve dhe mjeteve përkatëse, modelimin e proceseve të biznesit të TI/SI-së, projektimin e sistemeve/platformave TI/GIS dhe ekspertizë teknike të Infrastrukturës së TIK-ut.

Kompania duhet të propozojë një ekip ekspertësh të përbërë të paktën nga:

- Udhëheqësi i ekipit të projektit,
- Arkitekti i ndërmarrjes,
- Arkitekti i sistemit dhe
- Arkitekti i softuerit
- Analist i proceseve të biznesit

7.1 Kualifikimet kryesore të stafit

- a) Udhëheqësi i ekipit të projektit
 - i. Diplomë universitare në biznes, ekonomi, shkenca kompjuterike, sisteme të informacionit, inxhinieri softuerike.
 - ii. Certifikuar për Menaxhimin e Projektit (PMI, PRINCE2 ose ekuivalent).
 - iii. Të paktën 5 vite përvojë në menaxhim e projekteve të SI/TI-së
 - iv. Përvojë të mëhershme në zhvillimin dhe zbatimin e planeve në mënyrë ideale për një shkallë të gjerë të projekteve të TI-së. Kjo duhet të përfshijë zhvillimin e planeve programore me role dhe përgjegjësi të caktuara, monitorimin e performancës dhe menaxhimin e rreziqeve kryesore me projekte të orientuara drejt biznesit të TI/SI, e-Qeverisja, etj.
 - v. v. Aftësi në gjuhën angleze të shkruar dhe të folur (e detyrueshme).
- b) Arkitekt i ndërmarrjes,
 - i. Diplomë universitare në shkenca kompjuterike, sisteme të informacionit, ose inxhinieri softuerike.
 - ii. I certifikuar për TOGAF.
 - iii. Të paktën 5 vite përvojë si arkitekt në ndërmarrje.
 - iv. Përvojë dhe referenca të dëshmuara në krijimin e arkitekturës së sistemeve për të pasqyruar strategjitë dhe qëllimet e organizatës dhe krijimin dhe zbatimin e vizioneve dhe qëllimeve të biznesit.
 - v. Njohuri dhe përvojë të dëshmuar në përdorimin e mjeteve softuerike përkatëse për përshkrimin e arkitekturës së sistemit (Sparx Enterprise Architect, BiZZDesign, ose ekuivalente)
 - vi. v. Aftësi në gjuhën angleze të shkruar dhe të folur (e detyrueshme).
- c) Arkitekti i sistemit
 - i. Diplomë universitare në shkenca kompjuterike, sisteme të informacionit, ose inxhinieri softuerike.
 - ii. Të paktën 5 vite përvojë si arkitekt i sistemit.

- iii. Përvojë dhe referenca të dëshmuara në analizimin e arkitekturave aktuale shtetërore në gjithë sistemin, duke përfshirë aplikacione të paketuara dhe me porosi, modelimin e proceseve të biznesit dhe dizajnimin e arkitekturës së sistemit.
 - iv. Njohuri dhe përvojë të dëshmuar në përdorimin e mjeteve softuerike përkatëse për përshkrimin e arkitekturës së sistemit (Sparx Enterprise Architect ose ekuivalente)
 - v. v. Aftësi në gjuhën angleze të shkruar dhe të folur (e detyrueshme).
- d) Arkitekti i softuerit
- i. Diplomë universitare në shkenca kompjuterike, sisteme të informacionit, ose inxhinieri softuerike.
 - ii. Të paktën 5 vite përvojë si arkitekt i softuerit.
 - iii. Përvojë dhe referenca të dëshmuara në projektimin e arkitekturës së softuerit duke përfshirë standardet përkatëse, Arkitekturën e Orientuar në Shërbim (AOSH), arkitekturën e mikroshërbimeve, modelimin e të dhënave, menaxhimin e të dhënave hapësinore dhe aplikacionet e bazuara në ueb.
 - iv. Njohuri dhe përvojë të dëshmuar në përdorimin e mjeteve softuerike përkatëse për përshkrimin e arkitekturës së softuerit (Sparx Enterprise Architect, Rational Software Architect, Modelio, ose ekuivalente)
 - v. v. Aftësi në gjuhën angleze të shkruar dhe të folur (e detyrueshme).
- e) Analist i proceseve të biznesit
- i. Diplomë universitare në administrim biznesi, analitikë biznesi, menaxhim të operacioneve, sisteme të informacionit ose kualifikime të ngjashme me theks në analizën e procesit të biznesit.
 - ii. Të paktën 5 vite përvojë si analist i procesit të biznesit për identifikimin dhe dokumentimin e proceseve të biznesit të organizatave të mëdha të sektorit publik për zhvillimin e sistemeve të TI-së.
 - iii. Përveç kësaj, analisti i procesit të biznesit duhet të ketë përvojë në të paktën dy projekte në shkallë kombëtare që kanë të bëjnë me proceset e biznesit në administrimin e tokës ose ndonjë sektor të ndërlidhur (administratë publike, regjistër të biznesit dhe popullsisë, taksa, sisteme të planifikimit fizik, etj).
 - iv. v. Aftësi në gjuhën angleze, të shkruar dhe të folur (e detyrueshme).

8 Procesi i përzgjedhjes

Kompania do të përzgjidhet në bazë të:

- Ekspertizë e gjerë në konsulencë, zhvillimin e Strategjisë së TI-së, dizajnimin e arkitekturave të sistemit dhe mjeteve të ndërlidhura, në mjedise të mëdha të TI-së, duke përfshirë përvojën në ridizajnimin e arkitekturës së sistemit të TI-së (65%);
- Përvojë relevante të punës dhe referenca në zbatimin e projekteve të ngjashme në shkallë kombëtare (35%);

“Konsulentët me përvojë dhe të kualifikuar do të zgjidhen sipas dispozitave të Rregulloreve të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e Financimit të Projekteve Investuese (FPI), korrik 2016, bazuar në metodën e përzgjedhjes për Përzgjedhjen e Konsulentëve të Kualifikuar (CQ), (Përzgjedhja e Konsulentëve të Kualifikuar përmes Procedurës së Hapur Konkurruese)”.

9 Raportimi

Kompania do të punojë ngushtë me Drejtorin/Udhëheqësin e Drejtorisë së TI-së. Kompania do t'i raportojë Kryeshefit Ekzekutiv të AKK-së dhe Zyrës për Koordinim të Projekteve. Të gjitha raportet me shkrim duhet të sigurohen në gjuhën angleze, vetëm Strategjia Përfundimtare e TI-së dhe plani i zbatimit duhet të sigurohen në gjuhën angleze dhe shqipe. Raportet me shkrim do të sigurohen në formate të dakorduara në datat që mund të bien dakord reciprokisht gjatë takimit fillestar.